



## **Republika e Kosovës**

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme – Ministarstvo Unutrašnjih Poslova

Ministry of Internal Affairs

# RAPORT VLERËSUES

Zbatimi gjatë vitit 2013 i

Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planit të Veprimit

2011-2016



# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Lista e Shkurtesave .....                                                                                                                                                                      | 4  |
| Mesazhi i Zëvendësministrit .....                                                                                                                                                              | 5  |
| Hyrje .....                                                                                                                                                                                    | 7  |
| Përmbledhje Ekzekutive .....                                                                                                                                                                   | 9  |
| Metodologjia .....                                                                                                                                                                             | 11 |
| <b>PROGRESI I ARRITUR GJATË VITIT 2013 –</b>                                                                                                                                                   |    |
| <b>VLERËSIMI I SYNIMIT STRATEGJIK 1:</b> Shkalla e besimit publik në Institucionet Qeveritare dhe të Sigurisë është në ngritje të vazhdueshme .....                                            | 13 |
| <b>SYNIMI STRATEGJIK 2</b> Cenimi i Sigurisë Publike, Personale dhe të Pronës është në shkallë të ulët .....                                                                                   | 30 |
| <b>SYNIMI STRATEGJIK 3</b> Kthimi dhe ri-integrimi i qytetarëve nuk paraqitet si fidë teknike për liberalizimin e vizave apo në integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian ..... | 36 |
| <b>SYNIMI STRATEGJIK 4.</b> Çështjet e ndërlidhura me komunitetet jo-shumicë adresohen në mënyrë institucionale .....                                                                          | 37 |
| <b>SYNIMI STRATEGJIK 5.</b> Forumet e Sigurisë ndihmojnë intensivisht në implementimin e strategjive nacionale në nivelin lokal .....                                                          | 38 |
| <b>Objektivi specifik 6.</b> Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe koordinimi i aktorëve në nivel lokal dhe qendror për përmirësimin e sigurisë publike .....                                  | 39 |
| <b>SYNIMI STRATEGJIK 7.</b> Parandalimi dhe zvogëlimi i krimit në bashkësi .....                                                                                                               | 40 |
| <b>SYNIMI STRATEGJIK 8 –</b> Tranzicion i suksesshëm i EVSB-ve .....                                                                                                                           | 44 |
| <b>SFIDAT</b> .....                                                                                                                                                                            | 45 |
| <b>REKOMANDIMET</b> .....                                                                                                                                                                      | 46 |

## LISTA E SHKURTESAVE

|               |                                                                                                          |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>DSB</b>    | Divizioni për Siguri në Bashkësi                                                                         |
| <b>DSP</b>    | Departamenti për Siguri Publike                                                                          |
| <b>EVSB</b>   | Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi                                                                   |
| <b>FSK</b>    | Forca e Sigurisë së Kosovës                                                                              |
| <b>ICITAP</b> | Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnime për Hetime Penale                                         |
| <b>IKAP</b>   | Instituti i Kosovës për Administratës Publike                                                            |
| <b>KK</b>     | Kuvendi Komunal                                                                                          |
| <b>KKSB</b>   | Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi                                                                  |
| <b>KLSP</b>   | Komiteti Lokal për Siguri Publike                                                                        |
| <b>MAPL</b>   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                                                             |
| <b>MASHT</b>  | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë                                                           |
| <b>MKRS</b>   | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve                                                                |
| <b>MPB</b>    | Ministria e Punëve të Brendshme                                                                          |
| <b>OSBE</b>   | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                                          |
| <b>PK</b>     | Policia e Kosovës                                                                                        |
| <b>DPBP</b>   | Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë                                                          |
| <b>KPK</b>    | Kodi Penal i Kosovës                                                                                     |
| <b>UNDP</b>   | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                                                             |
| <b>ZKSB</b>   | Zyra Koordinuese për Siguri në Bashkësi                                                                  |
| <b>UA</b>     | Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL<br>"Për këshillat komunale për siguri në bashkësi" |
| <b>UAPK</b>   | Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2012 MPB " Bashkëpunimi Policor me Kuvendin komunal"                       |

# MESAZHI I ZËVENDËSMINISTRIT

Sa të sigurt dhe të lirë jemi ne si individë, është pyetja qendrore prapa idesë së sigurisë sot. Njëra ndër elementet qenësore dhe me ndikim të madh në jetën e njeriut pa dyshim është siguria si personale po ashtu edhe siguria shoqërore në përgjithësi. Siguria është një nga fenomenet themelore të shoqërisë njerëzore në të gjitha fazat e zhvillimit të saj. Pa marrë parasysh, a behët fjalë për sigurinë e individit, bashkësisë apo shtetit, çdo herë bëhet fjalë për synimet për të siguruar vlerat dhe gjendjen që konsiderohet si interes vital i secilit. Siguria është shqetësim gjithnjë e më i pranishëm për popullsinë. Shumica e individëve kanë nevojë për siguri në çdo aspekt, prandaj përmirësimi i sigurisë, si një objektiv i qartë, mund të jetë një forcë e fuqishme mobilizuese. Është pra e rëndësishme për të zhvilluar një qasje të përshtatshme për të lehtësuar arritjen e këtij qëllimi.



Çdo individ ka një rol për të luajtur në bërjen e bashkësive të sigurta, pavarësisht rrethanave të tilla si mosha, përkatësia etnike, gjinore apo besimin fetar.

Siguria në bashkësi të cilës i referohet ky raport vlerësues ka të bëjë me sigurinë në përgjithësi dhe cilësinë e jetës duke inkurajuar individët për të kërkuar mundësitë më të favorshme në dispozicion të tyre, për t'u mundësuar atyre të jetojnë jetën e tyre në mënyrë të sigurt dhe pa frikë nga krimi dhe çrregullimet.

Siguria është një e drejtë themelore dhe një kusht thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Siguria si e drejtë themelore e njeriut përveç që është e garantuar me konventa të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare, është e fuqizuar me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Politika dhe synimi kryesor i Ministrisë të Punëve të Brendshme është ofrimi i sigurisë kualitative për të gjithë qytetarët e Republikës përmes hartimit të politikave demokratike të sigurisë në bashkësi dhe stimulimit të bashkëpunimit dhe ndërtimit të partneriteteve të ndërsjella më të gjithë akteret dhe shoqërinë gjerë.

Natyrishisht se në kohën bashkëkohore, siguria nuk kuptohet më në një aspekt të ngushtë, vetëm të sigurisë personale, familjare apo të një grupi të vogël shoqëror, duke menduar se siguria është atëherë kur unë apo familja ime nuk do të kenë sulme fizike nga persona të tjerë.

Sot, siguria është një koncept mjaft i gjerë, koncept ky i cili kryesisht koncentrohet në një bashkëpunim të shëndoshë, të hapur, llogaridhënës dhe transparent me të gjithë, përfshirë edhe qytetaret përmes një partneriteti pro aktiv me qëllim të parandalimit të dukurive të ndryshme negative në shoqëri dhe të zgjidhjes së problemeve ekzistuese së bashku me bashkësinë.

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës ka hartuar Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planin e Veprimave 2011-2016, e cila tash e më pak së tre vite ka filluar zbatimin në tërë territorin e vendit.

Zbatimi i kësaj strategjie gjatë këtyre viteve është i karakterizuar me angazhime dhe suksese të arritura në aspektin e përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së jetesës. Kjo si rezultat i një qasjeje të përbashkët në hartimin e politikave koherente të sigurisë në bashkësi duke promovuar angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të të gjitha institucioneve vendore, ndërkombëtare, shoqërisë civile por edhe të gjithë qytetarëve.

Me këtë rast kam kënaqësinë që përmes këtij raporti vlerësues të zbatimit të Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planin e Veprimave 2011-2016 të shpreh mirënjohjet dhe falënderimet më të sinqerta për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile, forumet e sigurisë në bashkësi dhe të gjithë individët për angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar.

Kam besim të plotë se, me një vazhdimësi të qasjes dhe angazhimit të përbashkët në hartimin e politikave të cilat synojnë adresimin e të gjitha sfidave të sigurisë do të vazhdojmë të kontribuojmë në mirëqenien e të gjithë qytetarëve dhe për më tepër ofrimin e sigurisë të një kualiteti të lartë, pa frikë nga krimi dhe dukuritë tjera negative, të cilat mund të kenë ndikim në përmirësimin e sigurisë dhe ngritjen e kualiteti të jetës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

# HYRJE

## GRUPI DREJTUES PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË NACIONALE PËR SIGURI NË BASHKËSI DHE PLANI I VEPRIMIT 2011-2016



### Ministria e Punëve të Brendshme

pas aprovimit të Strategjisë Nationale për Siguri në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2011-2016 në vitin 2012 kishte marrë vendim që të themeloj një grup punues ndërministrorë, me përfshirje edhe të organizatave/agjencive vendore dhe ndërkombëtare joqeveritare dhe qeveritare për të bërë një mbikëqyrje efektive zbatimit të strategjisë në fjalë. Andaj, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, respektivisht Zëvendësministrit Izmi ZEKA, i cili njëherësh është edhe Koordinator Nacional i strategjisë, u themelua Grupi Drejtues për mbikëqyrjen e implementimit të Strategjisë Nationale dhe Planit të Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016, më poshtë i njohur si Grupi Drejtues.

Grupi Drejtues përbëhet nga këta përfaqësues të; Divizionit për Siguri Bashkësi, Ministria e Punëve të Brendshme; Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, Policia e Kosovës; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Zyra për Çështje të Komuniteteve, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Ndërsa, në cilësinë e partnerëve strategjikë dhe këshilltarëve, Grupi Drejtues në përbërjen e vet ka edhe përfaqësues nga: Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi, Misioni i OSBE-së në Kosovë; Departamenti i Drejtësisë Amerikane, Programi ICITAP; UNDP/KOSSAC; Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ); dhe Saferworld.

Grupi drejtues ka themeluar sekretarinë profesionale e cila përbëhet nga dy përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme respektivisht Divizioni për Siguri në Bashkësi dhe një përfaqësues nga Policia e Kosovës respektivisht Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë.

Roli kryesorë i Grupit Drejtues është mbikëqyrja dhe koordinimi i aktiviteteve, nismave dhe projekteve që kontribuojnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi në arritjen dhe realizimin e synimeve strategjike të Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2011-2016. Përveç rolit mbikëqyrës dhe koordinues, Grupi Drejtues ka qenë dhe mbetet bosht kryesorë në garantimin e zbatimit të suksesshëm të strategjisë duke dhënë edhe kontributin e vet direkt në zbatimin e planit të veprimit të strategjisë përmes aktiviteteve të tyre të rregullta në nivelin nacional dhe lokal.

Grupi Drejtues tashmë ka miratuar edhe planin e vet të punës për vitin 2014 që tregon për efikasitetin dhe angazhimin e madh të secilit anëtarë drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga strategjia dhe plani i punës duke kontribuar kështu në rritjen ndjenjës së sigurisë nga qytetarët e Kosovës.



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**R**aporti Vlerësues është shkruar nga Grupi Drejtues dhe ka për qëllim prezantimin e të arriturave dhe sfidave në implementimin e Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi 2011-2016 dhe Planit të Veprimit për periudhën raportuese janar - dhjetor 2013.

Raporti synon të ofrojë informata të duhura për institucionet përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare si dhe palët tjera të interesuara, në lidhje me të arriturat dhe sfidat, në implementimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi 2011-2016.

Qëllimi i këtij raporti, ndër të tjera është që të përmbushen synimet kryesore të Grupit Drejtues si organ mbikëqyrës, koordinues dhe mbështetës, që të jetë i informuar për të gjitha aktivitetet apo nismat e veprimit policor të orientuar në bashkësi, parandalimit të krimit si dhe të vlerësoj progresin e arritur gjatë vitit 2013 në fushën e sigurisë në bashkësi në Republikën e Kosovës.

Grupi Drejtues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi, ka diskutuar në vazhdimësi gjatë takimeve të rregullta dhe përmes aktiviteteve të ndryshme, qoftë përmes ofrimit të praktikave dhe shembujve konkret apo përmes angazhimit në terren, ka ofruar ndihmë për nivelin lokal, me qëllim të zbatimit të Strategjisë si dhe arritjen e synimeve dhe objektivave të parapara me plan.

Vlerësimi është bërë duke shikuar në hollësi aktivitetet e ndërmarra dhe pengesat e identifikuar në arritjen e nëntë (9) *Synimeve Strategjike dhe objektivave përcjellëse të secilit synim strategjik.*

Disa nga vlerësimet e përgjithshme të të arriturave në fushën e sigurisë në bashkësi dhe zbatimin e kësaj strategjie janë:

- Besimi i publikut në Institucionet e Sigurisë është i kënaqshëm ku kënaqshmëria e përgjithshme e publikut në institucionet e sigurisë, krahasuar me kënaqshmërinë e përgjithshme të publikut me Qeverinë, është dukshëm më i lartë. Vlen të theksohet se kënaqshmëria e publikut me institucionet e sigurisë është relativisht e lartë në mesin e të anketuarve shqiptarë, me një përqindje prej 62 përqind, ndërsa komunitetet tjera janë të kënaqura në një nivel prej 57 përqind.
- Është me rëndësishme të ceket se në mesin e Institucioneve të Sigurisë, institucioni më i besueshëm mbetet Policia e Kosovës. Përderisa kënaqshmëria me Qeverinë e Kosovës është vetëm 27 përqind, kënaqshmëria me punën e Policisë së Kosovës është dukshëm më e lartë, me gjithsejtë 75 përqind, ndërsa 85 përqind e shqipëtarëve, përkatësisht 16 përqind e të anketuarve serb janë të kënaqur me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

- Bazuar në një hulumtim të ndërmarrë nga Grupi drejtues për monitorimin dhe zbatimin të Strategjisë Nacionale për Sigurinë në Bashkësi si dhe vizitat e realizuara nga anëtarët e GD gjatë vitit 2013 nëpër Komunitatet e Kosovës, mund të thuhet se ka pasur një përparim të dukshëm sa i përket mbajtjes së takimeve të KKS-së nëpër Komunitatet e Kosovës.
- Shqetësues mbetet fakti se në disa Komunitate, KKS-ja nuk kryesohet nga kryetari i komunës, ashtu siç është e paraparë me UA e cila ndikon drejtëpërdrejtë në mos koordinimin e politikave dhe veprimeve në fushën e sigurisë publike.
- Duhet theksuar se Hani i Elezit, është komuniteti i cili ka mbajtur numrin më të madh të takimeve të KKS-së, më gjithsejtë 10 takime, edhe përkundër që obligative janë vetëm 6 takime duke dhënë një shembull të mirë edhe për komunitetet e tjera për rëndësinë që i kushtohet këtij trupi komunal.

# METODOLOGJIA

Grupi Drejtues ka punuar për së afërmi në zbatimin e kësaj strategjie, në konceptim, në çështjet e përfshira gjatë përpilimit, ku kanë organizuar takime për të parë se si operojnë marrëdhëniet në mes të mekanizmave kompetent ne menaxhimin e sigurisë në bashkësi si dhe detajet në sistemet e përfshira në politikat e integruara në proces të ofrimit të sigurisë në bashkësi.

Gjatë fazës së parë të hartimit të vlerësimit, palë të interesuara: vendore dhe ndërkombëtare, janë njoftuar me konceptin bazë të nevojës për një vlerësim vjetor. Në përpilimin e vlerësimit, grupi është bazuar në të gjitha dokumentet e qeverisë si dhe strategjinë për siguri në bashkësi, që përfshijnë sigurinë në bashkësi si koncepti i ri, krijimin e mekanizmave komunal për fushën e sigurisë në bashkësi, bërjen e qytetarit pro-aktiv në fushën e sigurisë, procesin njoftimit me politikat ri-integrimin etj.

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti është bazuar në të dhëna të mbledhura nga rishikimi i projekteve , aktiviteteve, publikimeve dhe analizave të ndërmarra nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë në bashkësisë, perceptimin e qytetarëve mbi institucionet e sigurisë si dhe statistikat e Policisë së Kosovës.<sup>1</sup>

Si pasojë, është vendosur të bëhet unifikimi i komponentëve kyç të sigurisë në bashkësi dhe përderisa grupi pranon se, mund të kenë përfituar nga ekzistimi i një përvoje të punës siguri në bashkësi (nga organizatat ndërkombëtare), dhe gjithashtu beson se ky dokument paraqet drejtimin dhe kornizën e përgjithshme në këtë drejtim.

Si e tillë, *vlerësimi* ofron një përmbledhje të veprimeve për realizimin e aktiviteteve dhe objektivave, raporteve si dhe politikave të cilat reflektojnë në pjesët e synimeve të strategjisë. Për më shumë, grupi ka qenë i informuar rreth procesit të përgjithshëm të zbatimit të strategjisë si dhe niveli i zbatimit nga ana e ministrive, agjencive dhe komunat. Gjatë përpilimit të këtij *vlerësimi* janë zhvilluar konsultime të burimeve statistikore dhe burime tjera.

Ky raport nuk përmban vlerësimin e të gjitha aktiviteteve të ndërmarra në Komunat e ndryshme gjatë periudhës raportuese, por aktivitetet kryesore me të cilat kanë qenë të informuar edhe Grupi Drejtues gjatë këtij viti.

Gjithashtu, raportet e rregullta të Grupit Drejtues për monitorimin e Implementimit të Strategjisë për Siguri në Bashkësi, kanë qenë një burim i rëndësishëm i informatave për hartimin e këtij dokumenti.

Metodë tjetër e përdorur për hartimin e këtij raporti është mbledhja e të dhënave për vlerësimin e Strategjisë për Siguri në Bashkësi, përmes diskutimeve dhe punës grupore gjatë punimeve në Punëtorinë tre ditore “ Strategjia për Siguri në Bashkësi- Vlerësimi i progresit dhe rruga përpara”, organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në mbështetje të Grupit Drejtues për mbikëqyrjen e implementimit të Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2011-2016, e cila u mundësia falë mbështetjes të projektit KOSSAC të UNDP-së.

Në këtë punëtori ku kanë marrë pjesë anëtarët e Grupit Drejtues si dhe anëtarët e jashtëm nga Organizatat ndërkombëtare si: UNDP, OSBE dhe ICITAP, është punuar në vlerësimin e strategjisë dhe përmes diskutimit janë identifikuar një mori të arriturash dhe sfidash në fushën e sigurisë në bashkësi, por njëkohësisht ka shërbyer edhe si një forum diskutimi mbi mënyrat më të mira për të përmirësuar çështjet problematike të identifikuara, rritjen e bashkëpunimit si dhe hartimin e Planit të Punës për vitin 2014.

Raporti fillimisht ofron një vlerësim të përgjithshëm të të arriturave që janë bërë në implementimin e strategjisë, duke marrë për bazë ato synime dhe objektiva ku është shënuar progres. Gjithashtu, edhe për synimet dhe objektivat për të cilat nuk ka pasur progres është dhënë një vlerësim i përgjithshëm.


Në fund, raporti përmban edhe rekomandimet të cilat janë ndërtuar mbi bazën e sfidave të identifikuara, me qëllim të identifikimit të aktiviteteve për të përmirësuar implementimin e strategjisë gjatë vitit të ardhshëm dhe arritjen e këtyre objektivave.

# PROGRESI I ARRITUR GJATË VITIT 2013

## Vlerësimi i synimit strategjik 1: Shkalla e besimit publik në Institucionet Qeveritare dhe të Sigurisë është në ngritje të vazhdueshme

Natyrisht, se mbi bazën e hulumtimeve që janë bërë në lidhje me shkallën e besimit publik në Institucionet Qeveritare dhe atyre të Sigurisë, nuk mund të thuhet se ka pasur ngritje të vazhdueshme të besimit të publikut përgjatë viteve.

Tabela 1: Kënaqshmëria me institucionet e sigurisë, sipas përkatësisë etnike<sup>2</sup>



Të dhënat për periudhën vlerësuese të vitit 2013, tregojnë se kënaqshmëria me punën e Qeverisë ka shënuar një rritje të lehtë prej 6 përqind. Rezultatet e perceptimit të publikut tregojnë se kënaqshmëria e publikut me punën e Qeverisë na Prill të vitit 2012 ka qenë në nivel prej 21 përqind, ndërsa në vitin 2013, kjo përqindje është rritur në 27 përqind e të anketuarve të cilët janë deklaruar se janë të kënaqur me punën e Qeverisë.<sup>3</sup>

Megjithatë, kënaqshmëria e përgjithshme e publikut me institucionet e sigurisë, krahasuar me kënaqshmëria e përgjithshme e publikut me Qeverinë, është dukshëm më e lartë. Vlen të theksohet se kënaqshmëria e publikut me institucionet e sigurisë është relativisht e lartë në mesin e të anketuarve shqiptarë, me një përqindje prej 62 përqind, ndërsa komunitetet tjera janë të kënaqura në një nivel prej 57 përqind.

Por, nëse krahasojmë të gjeturat aktuale, Tetor 2013, me ato të Tetorit 2012, niveli i kënaqshmërisë me institucionet e sigurisë ka shënuar një rënie, si për shqiptarët ashtu edhe për serbët.

<sup>2</sup> UNDP, Pulsi Publik 6, faqe 10

<sup>3</sup> UNDP, Pulsi Publik 6, faqe 10

Është e rëndësishme të ceket se nga Institucionet e Sigurisë, institucionet më i besueshëm mbetet Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Përderisa kënaqshmëria me Qeverinë e Kosovës është vetëm 27 përqind, kënaqshmëria me punën e Policisë së Kosovës është dukshëm shumë e lartë, me gjithsejtë 75 përqind.

Sipas raportit të fundit të Pulsit Publik kemi një trend pozitiv sa i përket kënaqshmërisë me punën e Policisë së Kosovës, prej 5 përqind, kur krahasojmë të dhënat e anketës së Prillit 2012 në raport me të dhënat e anketës së Prillit 2013. Madje, 85 përqind të të anketuarve shqiptar janë të kënaqur me punën e FSK-së. Edhe tek të anketuarit serb, kënaqshmëria me FSK-në ka shënuar rritje.

Gjithashtu, edhe Raporti i Progresit i KE-së për vitin 2013, vlerëson Policinë e Kosovës si institucionin më të besueshëm në fushën e sigurisë.<sup>4</sup>

Sa i përket ndjenjës së sigurisë është e rëndësishme të theksohet se përqindja e të anketuarve të cilët deklarojnë se ndjehen të sigurt është shumë e lartë, në mbi 82 përqind, ndërsa vetëm 15 % kanë deklaruar se ndjehen përgjithësisht të pasigurt.

---

<sup>4</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2013.



## Objektivi specifik 1 - Institucionet Qeveritare dhe të Sigurisë janë pro-aktive dhe kanë të zhvilluar programe parandaluese

Ministria e punëve të brendshme përmes mekanizmave institucional është organizuar në hartimin dhe zbatimin e programeve parandaluese për sigurinë e qytetarëve nga Divizioni për Siguri në bashkësi.

DSB-ja ka organizuar tryezë të rrumbullakët me temë “Fishekzjarret dhe Siguria- të arriturat dhe vështirësitë” në bashkëpunim me shkollën amerikane/ASK, poashtu me mbështetjen nga UNDP Kossac janë shtypur fletushka 1500 shqip dhe 500 serbishtë për përdorim më të sigurt të fishekzjarreve.

Divizioni për siguri në bashkësi në mbështetje nga Zyra për informim me publikun/ MPB në vitin 2013 ka mbajtur fushatë vetëdijësuese. me moto: “Fishekzjarret argëtojnë, por edhe lëndojnë”

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme**  
**Ministarstvo Unutrašnjih Poslova**  
*Ministry of Internal Affairs*

**Departamenti për Siguri Publike**  
**Departman za Javnu Bezbednost**  
*Department of Public Safety*

**Fishekzjarret argëtojnë, por edhe lëndojnë**

- Përdorimi i pakujdesshëm i fishekzjarrëve gjatë festave të fundvitit është shkak i kryesor i lëndimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës.
- Mos i lejoni fëmijët e vegjël që të përdorin fishekzjarret pa përkujdesjen e prindërve, duke përfshirë edhe xhaxhallorjat.
- Asnjëherë, mos u jepni fishekzjarrë fëmijëve nën moshën 7 vjeçare.
- Në asnjë mënyrë mos iu afroni fishekzjarrëve të dëmtuara.
- Në asnjë mënyrë mos mbani fishekzjarrë në xhapat tuaj.

**Sipas legjislacionit në fuqi, shitja e fishekzjarrëve është e lejuar nga 19 deri 31 dhjetor, ndërsa përdorimi i tyre është i lejuar nga 26 dhjetor deri më 2 janar.**

- Asnjëherë mos ju shitni fishekzjarrë personave nën moshën 12 vjeçare.
- Nuk lejohet posedimi i fishekzjarrëve nga personat nën moshën 12 vjeçare.
- Mos u tregoni të pakujdesshëm ndaj fishekzjarrëve, ato ju lëndojnë.
- Ato duhet të bëhen në mënyrë legale, të përdoren sigurt dhe me kujdes të veçantë.
- Mos i përdor fishekzjarrët në afërsi të familjeve, grave shtatzëna dhe të moshuarve.
- 21 persona janë lënduar vitin e kaluar si pasojë e përdorimit joadekuat të fishekzjarrëve.
- Ministria e Punëve të Brendshme apelon që gjatë festave të fund-vitit, fishekzjarrët të përdoren në mënyrë të sigurt dhe të lexohen me kujdes udhëzuesit për përdorim.

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë në bashkëpunim me dikasteret respektivë, gjatë vitit 2013 ka mbajtur ligjërata nëpër shkollat e mesme të Kosovës rreth pasojave që shkakton përdorimi i substancave narkotike si dhe sanksionet penale sipas Kodit Penal të Kosovës.



**Tabela e ligjëratave të mbajtura:**

| Vendi        | Shkolla                 | Numri i pjesmarrësve | Klasët         |
|--------------|-------------------------|----------------------|----------------|
| Pejë         | Salla e kulturës        | 300                  | X, XI, XII     |
| Gjakovë      | Salla e kulturës        | 1036                 | IX, X, XI, XII |
| Istog        | Haxhi Zeka              | 150                  | X, XI, XII     |
| Ferizaj      | Salla e Kulturës        | 600                  | X, XI, XII     |
| Lipjan       | Salla e Kulturës        | 400                  | X, XI, XII     |
| Prishtinë    | Stacioni Qendra         | 34                   | IX             |
| Rogojicë     | Metush Krasniqi         | 80                   | X, XI          |
| Prishtinë    | 28 Nëntori              | 70                   | X, XI, XII     |
| Mitrovicë    | Frank Bardhi            | 120                  | X, XI, XII     |
| Prizren      | 11 Marsi                | 350                  | X, XI, XII     |
| Prizren      | Ymer Prizreni, Remzi A. | 350                  | X, XI, XII     |
| Prizren      | SH.M E Mjekësisë        | 350                  | X, XI, XII     |
| Pejë- Debat  | Universiteti Evropian   | 100                  | Studentë       |
| Kamenicë- D. | Salla e kulturës        | 80                   | X, XI, XII     |
| Gjithsejt    |                         | 4020                 | IX, X, XI, XII |
| Debate       |                         | 380                  |                |



DPBP ka zbatuar projektin për parandalimin e të shtënave me armë gjatë ahengeve të ndryshme të organizuara nga qytetarët me titullin “Festo me Zemër e Jo me Armë”

**Tabela me statistikat nga projekti “Festo me Zemër e Jo me Armë”**

| Qershor,<br>korrik, gusht<br>dhe shtator<br>2011/2012<br>2013 | PEJË |      |      | FERIZAJ |      |      | MITROVICË |      |      | GJILAN |      |      | PRISHTINË |      |      | PRIZREN |      |      | Total |      |      |
|---------------------------------------------------------------|------|------|------|---------|------|------|-----------|------|------|--------|------|------|-----------|------|------|---------|------|------|-------|------|------|
|                                                               | 2011 | 2012 | 2013 | 2011    | 2012 | 2013 | 2011      | 2012 | 2013 | 2011   | 2012 | 2013 | 2011      | 2012 | 2013 | 2011    | 2012 | 2013 | 2011  | 2012 | 2013 |
| <b>Numri i rasteve</b>                                        | 18   | 15   | 5    | 5       | 8    | 8    | 11        | 9    | 9    | 5      | 6    | 6    | 46        | 72   | 55   | 6       | 20   | 11   | 91    | 130  | 93   |
| <b>Numri i konfiskimit të pistoletave</b>                     | 5    | 6    | 2    | 6       | 12   | 7    | 10        | 7    | 5    | 4      | 7    | 5    | 31        | 56   | 32   | 4       | 10   | 4    | 60    | 98   | 55   |
| <b>Numri i konfiskimit të armëve të gjata</b>                 | 12   | 4    | 5    | 2       | 0    | 0    | 8         | 11   | 4    | 2      | 1    | 2    | 20        | 25   | 24   | 5       | 11   | 4    | 49    | 52   | 39   |
| <b>Numri i konfiskimit të municioneve</b>                     | 62   | 368  | 0    | 49      | 58   | 34   | 93        | 321  | 8    | 19     | 150  | 22   | 356       | 456  | 176  | 160     | 197  | 72   | 739   | 1550 | 314  |
| <b>Numri i konfiskimit të gëzhojave</b>                       | 85   | 33   | 73   | 3       | 3    | 3    | 28        | 126  | 27   | 12     | 196  | 20   | 116       | 163  | 103  | 130     | 40   | 16   | 374   | 661  | 242  |
| <b>Numri i të arrestuarve</b>                                 | 8    | 16   | 8    | 3       | 3    | 2    | 4         | 19   | 6    | 0      | 13   | 3    | 3         | 55   | 39   | 0       | 9    | 1    | 18    | 115  | 59   |
| <b>Numri i rasteve të dërguara ne Prokurori apo Gjykatë</b>   | 18   | 15   | 6    | 5       | 8    | 5    | 11        | 9    | 9    | 4      | 5    | 6    | 46        | 65   | 56   | 6       | 20   | 7    | 90    | 122  | 89   |

Misioni i OSBE në Kosovë, gjatë periudhes Janar-Dhjetor 2013 ka monitoruar punën e KLSP-ve, kryesisht duke u fokusuar në punën e policisë. Si rezultat i monitorimit OSBE ka prodhuar raporte vlerësuese për KLSP-të me këshilla dhe relomandime për PK-në, për mënyrat për të përmirësuar funksionimin e tyre. Ky monitorim ka dëshmuar se PK-ja rregullisht merr pjesë në mbledhjet e KLSP-ve dhe ndërmerr veprime adekuate ndaj çështjeve të ngritura të sigurisë nga anatarët e KLSP-ve. Si një ndër sfidat për funksionimin e plotë të KLSP-ve vlerësohet të jetë mungesa e nxitjes financiare për KLSP-të. Për përmbushjen e këtij objekti, në Planin e Veprimit të strategjisë janë paraparë një numër aktivitete të cilat do të duhej të realizoheshin përgjatë viteve 2011-2016 e që do të kishin ndikim në arritjen e objektivit specifik 1.

### Aktiviteti 1.1.2 : Takimet e KKSB-së duhet të jenë të rregullta dhe të adresojnë çështjet konkrete të ngritura nga përfaqësuesit e EVSB ve dhe KLSP-ve

Për përmbudhjen e këtij objekti, Grupi Drejtues ka ndërmarrë disa iniciative gjatë vitit 2013. Bazuar në një hulumtim të ndërmarrë nga Grupi drejtues për monitorimin dhe zbatimin e strategjisë për sigurinë në bashkësi si dhe vizitat e realizuara nga anëtarët e këtij grupi gjatë vitit 2013 nëpër Komunitet e Kosovës, mund të thuhet se ka pasur një përparim të dukshëm sa i përket konsolidimit të KKSB-ve sipas Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL "Për këshillat komunale për siguri në bashkësi nëpër Komunitet e Kosovës" si dhe mbajtjen e takimeve.

Megjithatë, shqetësues mbetet fakti se në disa Komuna, KKSB-ja nuk kryesohet nga kryetari, ashtu siç është e paraparë me Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, e cila ndikon drejtëpërdrejtë në mos koordinimi i politikave dhe veprimeve në fushën e sigurisë publike.


Hani i Elezit, është Komuna e cila ka mbajtur numrin më të madh të takimeve të KKSB-së, më gjithsej 12 takime, edhe përkundër se obligative janë vetëm 6 takime, duke dhënë një shembull të mirë edhe për Komunitet e tjera për rëndësinë që i kushtohet këtij trupi komunal.

**Tabela 1: Numri i takimeve të KKSB-ve, sipas Divizionit për Siguri në Bashkësi, 2013**

| Nr | Komuna       | Funksionale | Jo-Funksionale | Numri i takimeve të KKSB-së në 6 mujorin e parë | Numri i takimeve të KKSB-së në 6 mujorin e dytë |
|----|--------------|-------------|----------------|-------------------------------------------------|-------------------------------------------------|
| 1  | Prishtinë    | Po          |                | 3                                               | 1                                               |
| 2  | Podujevë     | Po          |                | 3                                               | 1                                               |
| 3  | Fushë Kosovë | Po          |                | 3                                               | /                                               |
| 4  | Obiliq       | Po          |                | 3                                               | /                                               |
| 5  | Lipjan       | Po          |                | 3                                               | 2                                               |
| 6  | Drenas       | Po          |                | 3                                               | /                                               |
| 7  | Graçanicë    | Po          |                | 3                                               | /                                               |
| 8  | Istog        | Po          |                | 3                                               | 1                                               |
| 9  | Klinë        | Po          |                | 3                                               | 3                                               |
| 10 | Pejë         | Po          |                | 2                                               | 2                                               |
| 11 | Deçanë       | Po          |                | 2                                               | 1                                               |
| 12 | Junik        | Po          |                | 3                                               | 1                                               |
| 13 | Gjakovë      | Po          |                | 1                                               | /                                               |
| 14 | Prizren      | Po          |                | 2                                               | /                                               |
| 15 | Suharekë     | Po          |                | 3                                               | 1                                               |
| 16 | Malishevë    | Po          |                | 3                                               | /                                               |
| 17 | Rahovec      | Po          |                | 3                                               | /                                               |

|    |               |                                                                  |    |                         |
|----|---------------|------------------------------------------------------------------|----|-------------------------|
| 18 | Dragash       | Po                                                               | 2  | 1                       |
| 19 | Mamushë       | Po                                                               | 0  | 1                       |
| 20 | Gjilan        | Po                                                               | 2  | 1                       |
| 21 | Novobërdë     | Po                                                               | 3  | 3                       |
| 22 | Kamenicë      | Po                                                               | 3  | /                       |
| 23 | Viti          | Po                                                               | 3  | 1                       |
| 24 | Klllokot      | Po                                                               | 3  | /                       |
| 25 | Partesh       | Po                                                               | 2  | 2+ 2 jasht<br>zakonshme |
| 26 | Ranillug      | Po                                                               | 1  | /                       |
| 27 | Kaçanik       | Po (në bazë të UA. të kaluar Nr.<br>08/2009 MPB – 02/2009 MAPL ) | 2  | 2                       |
| 28 | Hani i Elezit | Po                                                               | 6  | 6                       |
| 29 | Ferizaj       | Po                                                               | 1  | /                       |
| 30 | Shtime        | Po                                                               | 2  | 2                       |
| 31 | Shtërpçë      | Po                                                               | 0  | 1                       |
| 32 | Skenderaj     | Po në bazë të UA. të kaluar Nr.<br>08/2009 MPB – 02/2009 MAPL )  | 0  | 1                       |
| 33 | Mitrovicë     | Po                                                               | 1  | 1                       |
| 34 | Vushtrri      | Po                                                               | 3  | 1                       |
| 35 | Zubin Potok   | Jo                                                               | /  | /                       |
| 36 | Zveçan        | Jo                                                               | /  | /                       |
| 37 | Leposaviç     | Jo                                                               | /  | /                       |
|    |               |                                                                  | 83 | 24                      |


### Rajoni i GJILANIT



**Figura 1.**

Numri i takimeve të mbajtura të Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi për regjionin e Gjilanit


### Rajonini FERIZAJIT



**Figura 2.**

Numri i takimeve të mbajtura të Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi për regjionin e Ferizajt


### Rajoni i MITROVICËS



**Figure 3.**

Numri i takimeve të mbajtura të Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi për regjionin e Mitrovicës


### Rajoni i PRISHTINËS



**Figure 4.**

Numri i takimeve të mbajtura të Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi për regjionin e Prishtinës


### Rajoni i PEJËS



**Figure 5.**

Numri i takimeve të mbajtura të Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi për regjionin e Pejës

### Rajoni i PRIZRENIT



**Figure 6.**

Numri i takimeve të mbajtura të Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi për regjionin e Prizrenit

Duke u bazuar në raportin mbi aktivitetet e KKSBB-së, i hartuar nga DSB-ja, në takimet të cilat kemi marr pjesë si dhe në bazë të procesëverbaleve mund të dalim me këto Konkluzione:

1. Në shumicën e komunave në gjashtë (6) mujorin e dytë të 2013, takimet e KKSBB-së nuk janë mbajtur për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës.
2. Shqetësim tepër alarmant ishin bredhja e shumë qenve endacak në shumicën e komunave;
3. Siguria në komunikacion, mos vendosja e shenjave të komunikacionit, të merren masa më të ashpra ndaj atyre që nuk respektojnë rregullat në trafik si masë preventive;
4. Shtimi i vjedhjeve të pasurive të qytetarëve janë shqetësuese për banorët;
5. Patrullat e pakta policore nëpër zona të ndryshme, në veçanti aferë shkollave ku frekuentimi është më i madhë;
6. Të merren të gjitha masat për largimin e veturave nga trotualet, për lirim të lëvizjes nëpër trotuar;
7. Të vazhdohet plani PK rrethe bastisjes së autobusëve që bartin Nxënës, në parandalimin dhe eliminimin e dukurive të dyshimta negative.
8. Zhurma e madhe nga zëri i muzikës në kafiterit e qytetit. Kërkohet nga organet përkatëse komunale të ndermirren masa përkatëse në parandalimin e këtyre dukurive.
9. Kërkohet që Policia që të ketë nga një zyre nëpër bashkësitë lokale, që të jenë sa më afër qytetarëve për zgjedhjen e problemeve.
10. Mungesa e ndriçimit të rrugëve publike;
11. Siguria në shkolla, mungesa e trotuarëve;
12. Prerja e pyjeve në mënyrë ilegale;
13. Ndotja e ambientit, lumenjëve dhe hedhja e mbeturinave në vendet jo adekuate, në mungesë të shportave dhe deponive;
14. Ndërtimi i objekteve pa shkallë emergjente;
15. Të shtënat me arm zjarri nëpë ahengje, si dhe përdorimi i mjeteve piroteknike.

## Rekomandimet e përgjithshme

Duke parë shqetësimet dhe sfidat e qytetarëve me të cilat ata përballen në përditshmëri, e tërë kjo lidhur me trendët aktuale është shumë e rëndësishme që të ndërtohen politika për parandalimin e dukurive negative në kohë të duhur, si dhe politika të cilat do t'iu ofrojnë qytetarëve siguri më e madhe, qetësi dhe lëvizje të liri për gjithë qytetarët pa dallime.

DSB-ja del me këto rekomandime për institucionet gjegjëse që të kenë parasysh shqetësimet e qytetarëve dhe bazuar në to të ndërmirren masa për të përmirësuar gjendjen e sigurisë dhe parandaluar dukuritë negative duke identifikuar fushat prioritare në periudha të ndryshme kohore.

- a. Kuvendet komunale të tri komunat veriore, të themelojnë KKSB-të konform U. A. Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB-të.
- b. Komunitet të njoftojnë me kohë MPB-në për mbajtjen e mbledhjeve të KKSB-së, si dhe të dërgohet ftesa me kohë, të caktohen koordinatorët e KKSB-ve në mënyrë që të lehtësoj komunikimin dhe informimin me ministrit MPB, MAPL, të respektohen dispozitat ligjore lidhur me dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KKSB-ve, në MPB dhe MAPL sipas U. A. të lartpërmendur.
- c. Rekomandohet që të shpërndahen informatat për mbledhjet e KKSB-ve, të informohen media lokale me qëllim të informimit të qytetarëve rreth situatës së sigurisë në komunë, të mbahen 2 takimet e KKSB-së me publike siç është e paraparë me UA.
- d. Kshillat Komunal për Siguri në Bashkësi të kenë bashkëpunim ndërkomunal, për çështjen e sigurisë në bashkësi në fusha të ndryshme.
- e. Të bëhet vendosjen e kamerave elektronike duke bërë vëzhgimin elektronik nëpër qytet, një gjë e tillë mund të sjellë një siguri më të madhe për të gjithë qytetarët dhe një kujdes më të madhë, parandaluar dhe identifikuar probleme (si model të merret komuna e Pejës dhe Mitrovicës së fundi, që kanë vendos vëzhgim elektronik).
- f. Rritja e bashkëpunimit në mes forumeve të sigurisë konkretisht KKSB-së, KLSP-së, EVSB-së dhe policisë së Kosovës.
- g. Të shtohet numri i patrollave policore në për rrugët magjistrale, të shtohen planet operative si masë preventive e parandalimit të aksidenteve në trafik sepse është evidente mungesa e tyre,
- h. Të paisen të gjitha rrugët me shenja sinjalizuese vertikale dhe horizontale, për një siguri më të madhe në komunikacionin rrugor, të merren masa më të ashpra ndaj atyre që nuk respektojnë rregullat në trafik, si masë preventive.
- i. Të ketë një koordinim ndër institucional të nivelit qendror dhe atë lokal si dhe OJQ-ve, për zgjedhjen e problematikës së qenve endacak sepse në të gjitha komunat janë shqetësim për sigurinë e qytetarëve me qëllim të parandalimit më të keqes.
- j. Të ketë masa më rigorozë nga institucionet lokale, në dhënën e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit të mos lejohet ushtrimi i kësaj veprimtarie në afërsi të Shkollave,
- k. Gjatë stinës së verës kur paraqitet edhe rrezikshmëria më e madhe e zjarreve, duhet të shtohen si masat por edhe aktivitete në sensibilizimin e qytetarëve në parandalimin e përhapjes së zjarreve, ku rol të rëndësishëm mund të luajnë edhe EVSB-të, KLSP-të si dhe këshillat lokale të zgjedhur të fshatrave .

#### **Aktivitetit 1.1.4: Raporti vjetor MAPL-së për komunat e KS mërr për bazë dhe vlerëson punën e KKSBB-së sipas Udhëzimit Administrativ 2008/9**

Duke marrë për bazë, Raporti i funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, Janar-Qershor 2012, është përshkruar dhe vlerësuar edhe puna e KKSBB-së, vlerësim i cili është i bazuar në raportet monitoruese të cilat i posedon MAPL-ja, duke përmbushur në këtë mënyrë edhe obligimin ligjor i cili rrjedh nga UA për KKSBB-të.

#### **Aktiviteti 1.1.7. Hartimi i programeve që stimulon angazhimi vullnetar në aktivitetet në nivel lokal, në çështjet që i preokupojnë drejtpërdrejt njerëzit**

Misioni i OSBE ka mbështetur Grupin Drejtues për zbatimin e SNSB&PV 2011-2016 në hartimin e Udhëzuesit për Hartimin e Planit Vjetor të Punës për Këshillat Komunalë Për Siguri në Bashkësi (KKSBB) Ky udhëzues ka për qëllim që të ofroj rekomandime të qarta për KKSBB-të lidhur me hartimin e planeve vjetore të punës (në tekstin e mëtejme PVP).



Ky udhëzues do t'iu shërbej KKSBB-të për të hartuar planet vjetore të punës në mënyrë të duhur por edhe për punë më efikase e poashtu do t'i mundësoj KK-ve dhe organeve tjera brenda komunës, si PK-së dhe palëve tjera me interes në atë komunë, që të kenë më shume njohuri lidhur me atë se si t'i mbështesin KKSBB-të për realizimin e planeve të tyre për përmirësimin e sigurisë në bashkësi.

Udhëzuesi i hartuar, është publikuar, prezantuar dhe dorëzuar KKSBB-ve në takimin e mbajtur me kryesuesit e KKSBB-ve, mbështetur nga misioni i OSBE në Kosovë me datën 28.06.2013 në Hotel Emerald në Prishtinë.



## **Objektivi specifik 2 – Garantimi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës i qytetarëve në forumeve të sigurisë (KKSB, EVSB, KLSP) përfshirë shoqërinë civile në adresimin adekuat të nevojave nga institucionet**

Saferworld, në partneritet me organizatat FIQ dhe AKTIV, në kuadër të projektit “Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që të bëhen kontribuese më të efektshme në politikën e sigurisë dhe proceset e vendimmarrjes”, në periudhën qershor-korrik kanë zhvilluar 7 takime me qytetarë (Gjakovë, Gjiat, Mitrovicë –në jug dhe veri, Shtërpçë, Klinë dhe Prizren), për të diskutuar rreth çështjeve kryesore që prekin nivelin e paqes dhe të sigurisë në Kosovë. Në këto takime kanë marrë pjesë mbi 135 pjesëmarrës, ndërkaq janë zhvilluar edhe 11 intervista gjysmë të strukturuar. Raporti i nxjerrë është publikuar në një konferencë, të organizuar më 23 tetor 2013, me titull: “Pikëpamjet e qytetarëve rreth çështjeve kyçe të sigurisë në Kosovë”. Raporti ka analizuar katër tema: Shqetësimet lidhur me punën e policisë; Rreziku nga prania dhe përdorimi i drogës në mesin e të rinjve; Siguria në komunikacion; Mungesa e transparencës dhe qartësisë për marrëveshjet në dialogun Kosovë-Serbi. Pas konferencës në Prishtinë, ku morën pjesë afro 50 pjesëmarrës, nga institucione të ndryshme të vendit, organizata ndërkombëtare, përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediat, ky raport është sjellë në diskutim në tri tryeza komunale në Gjiat, Klinë dhe Mitrovicë Veriore.

### **Aktiviteti 1.2.1. Themelimi i forumeve të sigurisë (KKSB, KLSP, EVSB) në ato komuna ku nuk janë themeluar, mbështetje të forumeve ekzistuese dhe re-vitalizmi në rastet kur ka tendencë të ndërprerjes apo shuarjes**

Themelimit të forumeve të sigurisë, e në veçanti, KKSB-ve, i është kushtuar një vëmendje e veçantë nga Grupi Drejtues gjatë viti 2013. Në këtë mënyrë, GD ka përmbushur edhe synimet e përcaktuara me vendimin e MPB-së, për të mundësuar zhvillimin e politikave në nivel të Kosovës për implementimin e Strategjisë Nacionale dhe për ofrimin e rekomandimeve për organet të cilët kanë autoritetin të vendosin politikën e cila do të zbatohet në tërë Kosovën në nivel strategjik.

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave nga terreni, GD gjatë vizitave të realizuara me kryesuesit e KKSB-ve, ka vërejtur se në shumicën e komunave janë funksionale KKSB-rë, me përjashtim të Skenderajt dhe katër komunat e veriut: M. veriut, Leposaviç, Zveçan dhe Zubinpotok të cilat nuk janë funksionale.

Po ashtu, edhe gjatë këtij viti është bërë edhe revitalizimi dhe plotësimi me anëtarë të rinj të EVSB-ve në disa Komuna: si në Komunën e Dragashit dhe Lipjanit. Me vendim të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, janë themeluar KLSP të reja në lagjet Dardania/Emshir dhe fshatrat Hajvali/Shashkovc të Prishtinës, lagjen Kolonia dhe në fshatin Rugovë të Gjakovës si dhe në fshatin Zaskok të Ferizajt. Anëtarët e nacionaliteteve të ndryshme të këtyre KLSP-ve janë trajnuar dhe certifikuar nga ana e OSBE-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë dhe Zyrën Koordinuese për Siguri në Bashkësi.



### **1.2.2. Institucionet komunale garantojnë gjithë-përfshirje në forumet e sigurisë veçmas duke marrë për bazë aspektin e barazisë gjinore**

Sa i përket garantimit gjithëpërfshirës në forumet e sigurisë, veçmas duke marrë për bazë aspektin e barazisë gjinore, mund të thuhet se në të gjitha ato komuna, ku është e themeluar KKSB-ja ka gjithëpërfshirje, ashtu siç është paraparë edhe me UA KKSB-të, Neni 4 (Përbërja e KKSB-së).

Anëtarë të përhershëm përveç përfaqësuesve të Policisë dhe Drejtorive përkatëse janë edhe Zyrtarët për Barazi Gjinore, përfaqësuesit e secilit komunitet etnik të komunës përkatëse; Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse; Një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me nevoja të veçanta si dhe Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse.

### **1.2.3. Trajnimi fillestar, i rregullt dhe periodik i pjesëmarrësve dhe aktivistëve**

Misioni i OSBE në Kosovë ka zbatuar programin për trajnimin për pesë ( 5) KLSP-të e themeluara gjatë vitit 2013 në dy faza;

Faza e parë- katerdhjetë (40) anëtarë të pesë KLSP-të themeluara kanë marrë pjesë në trajnim fillestar për Policimin në Bashkësi për duke përfshirë modulet ndërtimi i partneriteteve dhe zgjidhja e problemeve.

Faza e dytë - Trajnimi i trajnerëve për siguri në bashkësi për anëtarët e zgjedhur të KLSP-të themeluara gjatë vitit 2013. Pesëmbdhjetë (15) pjesëmarrës nga KLSP-të e ndryshme janë trajnuar për të promovuar filozofinë e policimit në bashkësi dhe mbështetjen e projekteve dhe

aktiviteteve të sigurisë të bashkësi në tërë Kosovën. Në mënyrë që të zgjeroj partneritetin dhe aftësitë e zgjidhjes së problemit në komunitete, OSBE ka organizuar për anëtarët e zgjedhur të KLSP-ve një kurs trajnimi pesë ditor për trajnerët e sigurisë në bashkësi. Trajnimi ka përfshirë tema të tilla si: menaxhimin e mjedisit të trajnimit, principet e të mësuarit të të rriturve, metodat e mësimit, planifikimi i mësimit, projektimi dhe përdorimi efektiv i mjeteve ndihmëse për mësim, aftësitë lehtësuese për trajnerët që kanë të bëjnë me dinamikën e vështirësive, parimet, mjetet e sigurisë në komunitet dhe policimit në komunitet. Gjatë kursit, trajnerët lokal përmirësojnë njohuritë e tyre në teknikat specifike të trajnimit dhe në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit zhvillojnë dhe paraqesin planet e tyre mësimore. Këta trajnerët lehtësues të KLSP-ve lokale promovojnë filozofinë e policimit në komunitet dhe mbështetësin projektet e sigurisë së komunitetit dhe aktivitetet në tërë Kosovën

Qëllimi i këtij programi është që të zhvillojë njohuritë dhe shkathtësitë e pjesëmarrësve për adresimin efikas të çështjeve të krimit, sigurisë, rendit publik dhe mirëqenies. Programi fokusohet në zbatimin e parimeve themelore: bashkëpunim, pjesëmarrje, gjithë-përfshirje dhe qëndrueshmëri

#### **1.2.4. Takime me komunitetet jo-shumicë për të garantuar pjesëmarrjen në forumet e sigurisë**

Forumet e Sigurisë ( KKSBB-të, KLSP-të dhe EVSB-të) gjatë periudhës raportuese, nën mbështetjen edhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Divizionit për Siguri në Bashkësi si dhe të organizatave ndërkombëtare, kanë organizuar disa takime me komunitetin jo-shumicë si në Komunën e Klinës dhe Kamenicës me temën “ Kthimi i komuniteteve jo-shumicë”.

Në periudhën në mes të dy trajnimeve, me ndihmën e OSBE anëtarët e KLSP-ve kanë organizuar dhe moderuar takimet me bashkësinë e tyre. KLSP-të kanë qenë të suksesshme në mbledhjen e anëtarëve të bashkësisë së tyre në identifikimin dhe prioritizimin e çështjeve të sigurisë lokale dhe shqetësimeve për sigurinë Misioni i OSBE ka mbështetur organizimin e dhjetë takimeve të bashkësive. Rreth 500 anëtarë të bashkësive dhe aktorëve të tjerë kanë marrë pjesë në takimet e organizuara. Në këto takime janë të vendosura marrëdhëniet midis anëtarëve KLSP, përfaqësuesve të komunave, policisë, partnerëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve

#### **1.2.5. Organizmi i takimeve të rregullta të Këshillave Ekzekutiv të EVSB-ve dhe KLSP-ve**

Bazuar në praktikën e mëhershme, Takimet e KE të EVSB-ve dhe KLSP-ve, organizohen dy herë brenda një viti. Edhe gjatë vitit 2013, janë mbajtur dy takime të KE të EVSB-ve, një në muajin Prill, organizuar në Gjakovë dhe një në muajin Tetor, organizuar nga EVSB-ja e Vushtrrisë në bashkëpunim të ngushtë me Divizionin për Siguri në Bashkësi.



Këshilli Ekzekutiv i Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi mbledhet dy herë në vit dhe përbëhet nga dy deri në tre përfaqësues të përzgjedhur nga secila EVSB, në nivel të Kosovës.

Këshilli Ekzekutiv i EVSB-së paraqet një forum të rëndësishëm kombëtar ndër-komunal për komunikim, bashkëpunim dhe koordinim. Që nga viti 2004 e deri më tani janë mbajtur gjithsejtë 28 takime të Këshillit Ekzekutiv të EVSB.

Gjithashtu, janë mbajtur dy takime të Këshillit Ekzekutiv të Komiteteve Lokale për Siguri Publike ~ KLSP ~ ku Takimi i 10-të i KE-së të KLSP-ve është mbajtur në Qershor të vitit 2013, në Vushtrri në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues nga 35 KLSP-të e themeluara dhe funksionale në tërë Republikën e Kosovës dhe takimi i 11-të është mbajtur në Dhjetor të vitit 2013 Prishtinë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga 37 KLSP.





## Lista me KLSP-të e themeluara në Kosovë:

| KOMITETET LOKALE PËR SIGURI PUBLIKE ~ KLSP ~ |                           |                                                                                                   |                     |
|----------------------------------------------|---------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| Rajoni i Prishtinës                          |                           |                                                                                                   |                     |
| KOMUNA E PRISHTINËS                          |                           |                                                                                                   | Themelimi i KLSP-së |
| 1                                            | Keqekollë                 | Mbulon fshatrat e Prapashticë, Nishec, Ballaban, Hajkobillë dhe Glllogovicë.                      | 14.09.2011          |
| 2                                            | Bërnice e Poshtme         | Fshat i përzier me shqiptarë dhe serbë.                                                           | 13.09.2011          |
| 3                                            | Dardani-Emshir            | Lagje të banuara me shqiptarë.                                                                    | 10.04.2013          |
| 4                                            | Hajvali/Shashkovc         | Fshatra të banuara me shqiptarë dhe komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas.                        | 10.04.2013          |
| KOMUNA E GRAÇANICËS                          |                           |                                                                                                   |                     |
| 5                                            | Gushtericë e Ulët         | Fshat i banuar me Serbë.                                                                          | 13.09.2011          |
| 6                                            | Laplla Sellë              | Mbulon fshatrat Çagllavicë dhe Preoc.                                                             | 28.10.2011          |
| 7                                            | Kishnicë                  | Mbulon fshatra me banorë të përzier të Sushicë, Badovac dhe Kishnicë                              | 28.10.2011          |
| KOMUNA E LIPJANIT                            |                           |                                                                                                   |                     |
| 8                                            | Janjevë                   | Fshat i përzierë me Shqiptarë, Kroatë, Romë dhe Turq                                              | 13.09.2011          |
| KOMUNA E FUSHË KOSOVËS                       |                           |                                                                                                   |                     |
| 9                                            | Kuzmin, Lismir dhe Bresje | Mbulon fshatrat Kuzmin, Lismir dhe Bresje të banuar me Shqiptarë dhe Serbë, Romë dhe Ashkali).    | 09.11.2012          |
| Rajoni i Prizrenit                           |                           |                                                                                                   |                     |
| KOMUNA E PRIZRENIT                           |                           |                                                                                                   |                     |
| 10                                           | Mushnikovë                | Fshat i përzier me Boshnjakë, Shqiptarë dhe Serbë.                                                | 13.09.2011          |
| KOMUNA E DRAGASHIT                           |                           |                                                                                                   |                     |
| 11                                           | Krushevë                  | Fshat i banuar me Goranë.                                                                         | 13.09.2011          |
| Rajoni i Pejës                               |                           |                                                                                                   |                     |
| KOMUNA E PEJËS                               |                           |                                                                                                   |                     |
| 12                                           | Levoshë                   | Fshat i përzierë me Serbë dhe Shqiptarë.                                                          | 13.09.2011          |
| KOMUNA E ISTOGUT                             |                           |                                                                                                   |                     |
| 13                                           | Osojanë                   | Mbulon fshatrat Zallq, Kovragë, Kosh, Gurakodhe Llukaci i thatë të banuar me Shqiptarë dhe Serbë. |                     |
| KOMUNA E KLINËS                              |                           |                                                                                                   |                     |
| 14                                           | Dollc                     | Fshat të banuara me Shqiptarë dhe Serbë.                                                          |                     |
| 15                                           | Drenoc                    | Fshat i banuar me Shqiptarë dhe Serbë.                                                            |                     |
| KOMUNA E GJAKOVËS                            |                           |                                                                                                   |                     |
| 16                                           | Lagjësja e Kolonisë       | Lagje e banuar nga komunitet i Romve, Ashkalive dhe Egjiptasve                                    | 06.11.2013          |
| 17                                           | Fshati Rogovë             | Fshat i banuar me shqiptarë dhe ashkali.                                                          | 06.11.2013          |

| Rajoni i Gjilanit    |                                       |                                                                                                                           |            |
|----------------------|---------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| KOMUNA E GJILANIT    |                                       |                                                                                                                           |            |
| 18                   | Livoci i Epërm                        | Fshat i përzierë me banorë Shqiptarë dhe Serbë                                                                            | 13.09.2011 |
| 19                   | Rruga "Avdullah Presheva"             | Lagje e banuar me Romë, Shqiptarë dhe Serbë                                                                               | 13.09.2011 |
| 20                   | Ponesh                                | Fshat me banorë të përzierë Shqiptarë dhe Serbë                                                                           | 13.09.2011 |
| 21                   | Pograxhë                              | Fshat me banorë të përzierë Shqiptarë dhe Serbë                                                                           |            |
| KOMUNA E VITISË      |                                       |                                                                                                                           |            |
| 22                   | Pozharan                              | Fshat i banuar me Shqiptarë                                                                                               | 13.09.2011 |
| 23                   | Kabash                                | Mbulon fshatrat Rimanishte, Bince, Debellde, Begunce, Dobresh, Germov, Goshice, Sedovin të banuar me Shqiptarë dhe Serbë. | 13.09.2011 |
| 24                   | Vërboc, Gërncar                       | Fshatra me banorë të përzierë Serbë dhe Kroatë.                                                                           | 13.09.2011 |
| 25                   | Smirë, Vërban                         | Fshatra me banorë të përzierë Shqiptarë dhe Serbë.                                                                        | 13.09.2011 |
| KOMUNA E NOVOBËRDËS  |                                       |                                                                                                                           |            |
| 26                   | Labjan dhe Bostane                    | Fshatra me banorë të përzierë Shqiptarë, Serbë dhe Romë                                                                   | 13.09.2011 |
| KOMUNA E KAMENICËS   |                                       |                                                                                                                           |            |
| 27                   | Hogosht                               | Fshat i banuar me Shqiptarë                                                                                               | 13.09.2011 |
| 28                   | Berivojcë                             | Fshat i përzierë me Shqiptarë, Serbë dhe Romë                                                                             | 13.09.2011 |
| 29                   | Shipashnicë e E. dhe Shipashnice e U. | Fshatra me banorë të përzierë Shqiptarë dhe Serbë                                                                         | 13.09.2011 |
| 30                   | Muçivërc                              | Fshat i përzierë me Shqiptarë dhe Serbë                                                                                   | 13.09.2011 |
| 31                   | Karaçevë e E. dhe Karaqevë e U.       | Fshat i përzierë me Shqiptarë dhe Serbë                                                                                   | 13.09.2011 |
| Rajoni i Mitrovicës  |                                       |                                                                                                                           |            |
| KOMUNA E SKENDERAJIT |                                       |                                                                                                                           |            |
| 32                   | Runik, Suriganë dhe Bajë              | Fshat i përzierë me Shqiptarë dhe Serbë                                                                                   | 13.09.2011 |
| KOMUNA E VUSHTRRIË   |                                       |                                                                                                                           |            |
| 33                   | Prilluzhë                             | Mbulon fshatrat Gllavatin, Strovç, Zhilivodë, Bivolak, Beçuk me banorë shqiptarë dhe serbë.                               |            |
| 34                   | Bajskë                                | Mbulon fshatrat Gojbulje, Sllatinë, Karaçë, të banuar me Shqiptarë dhe Serbë                                              |            |
| KOMUNA E ZVEÇANIT    |                                       |                                                                                                                           |            |
| 35                   | Lipë                                  | Fshat i banuar me Shqiptarë                                                                                               | 13.09.2011 |
| RAJONI I FERIZAJIT   |                                       |                                                                                                                           |            |
| KOMUNA E FERIZAJIT   |                                       |                                                                                                                           |            |
| 36                   | Bablak                                | Mbulon fshatrat Babush i Serbëve, Talinoc i Muhaxherëve të banuar me Shqiptarë dhe Serbë                                  |            |
| 37                   | Lagjësja "Sallahane"                  | Mbulon fshatrat Doganaj dhe Zaskok të banuar me shqiptarë, serbë dhe komuniteti RAE.                                      | 20.11.2013 |

Në mënyrë që të sigurohet komunikimi i rregullt mes KLSP-ve në Kosovë, OSBE siguron mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Ekzekutiv të KLSP-ve (themeluar me mbështetjen e OSBE-së në vitin 2009). Ky është një organ koordinues, i cili përfshin përfaqësues nga të gjitha KLSP-të dhe ndihmon ata për të ndarë informacione në lidhje me aktivitetet e tyre. Gjithashtu, u ndihmon atyre që të zhvillojnë strategji të përbashkëta për të trajtuar probleme të ngjashme. Mbledhjet e Këshillit Ekzekutiv organizohen me fokus kryesor në sigurimin e qëndrueshmërisë së KLSP-ve, si një forum efektiv për sigurinë në komunitet. Deri më tani, Shtatë takime të Këshillit Ekzekutiv janë mbajtur me mbështetjen e OSBE-së.

Programi i ngritjes të kapaciteteve për KLSP-të ka qenë sukses i pamasë. Jo vetëm që pjesëmarrësit i ka pajisur me njohuri dhe shkathtësi të reja dhe të rëndësishme, por gjithashtu ka ofruar një mundësi të mirë për komunitetet e ndryshme që të përfshihen dhe të vijnë së bashku në program, të mësojnë për njëri-tjetrin, të shkëmbejnë informata, përvoja dhe të zhvillojnë rrjetin e bashkëpunimit. Informatat kthyes nga pjesëmarrësit janë të shkëlqyeshme dhe demonstrojnë përkushtimin e tyre për vlerat e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

## **Synimi strategjik 2 – Cenimi i Sigurisë Publike, Personale dhe të Pronës është në shkallë të ulët**

### **Objektivi specifik 1- Niveli i krimit, i konflikteve ndërmjet grupeve të ndryshme dhe i pakënaqësive publike është i ulët (nivel i pranueshëm)**

Kosova, bazuar në të dhënat nga Policia e Kosovës dhe raportet tjera është vendi me nivelin më të ulët të krimeve në rajon duke bërë kështu që niveli i krimit të jetë në nivel të pranueshëm.

Megjithatë, është e rëndësishme të ceket se sipas statistikave të Policisë së Kosovës, mbi krimin e regjistruar, kemi një rritje të incidenteve dhe krimit në Prishtinë, ndërsa edhe në Ferizaj numri i incidenteve ka qenë rritje por krimi ka pësuar rënie. Ndërsa, në regjionet tjera si Gjilan, Mitrovicë dhe Pejë kemi një ulje të ndjeshme të incidenteve dhe krimit në përgjithësi.

Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor, disa nga OJQ-të lokale të përkrahura nga Saferworld, FIQ dhe AKTIV (Klinë, Gjilan, Pejë dhe Mitrovicë Veriore) kanë zhvilluar 10 takime avokuese me institucione komunale për të adresuar përgjigjet dhe veprimet institucionale në çështje e sigurisë në komunikacion, prezencës dhe përdorimit të drogës tek të rinjtë dhe bashkëpunimit të policisë me qytetarë.

Në dhjetor, Saferworld, FIQ dhe AKTIV kanë përzgjedhur për të trajtuar përmes takimeve me qytetarë dukurinë e lypsisë në Kosovë dhe pasojat e reflektuara në sigurinë në bashkësi. Janë zhvilluar edhe 7 takime me qytetarë në: Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Mamushë, Graçanicë, Partesh dhe Zveçan, ku kanë marrë pjesë 97 qytetarë, ndërsa për nevoja të hulumtimit janë realizuar edhe 6 intervista të stukturuara me zyrtarë të institucioneve dhe organizatave të kësaj fushe. Analiza e kësaj teme do të publikohet në janar dhe do të diksutohet pastaj edhe në disa komuna.



Gjithashtu, në nëntor, UNDP KOSSAC në Brendshme, Divizionit për Siguri në Bashkësika organizuar dy punëtori në Komunën e Fushë Kosovës dhe Obiliqit për “Vlerësimin e Situatës së Sigurisë- Sfidat dhe prioritetet”. Pjesëmarrja nga dy komunat ka qenë shumë gjithëpërfshirëse ku kanë marrë pjesë gjithsejt 51 pjesëmarrës nga: KKSBB-të, KLSP-të dhe përfaqësues të komuniteteve. Si rezultat i kësaj punëtorie, në dhjetor të vitit 2013, me kërkesën e Policisë së Kosovës (Stacionit të Obiliqit), UNDP KOSSAC ka dhënë

bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të



donacion 3 kompjuterë dhe pasijet përcjellëse që do t'i shërbejnë për hapjes e zyreve në 3 fshatra të Komunës së Obiliqit, me qëllim të përmirësimit të sigurisë në bashkësi dhe rritjes së bashkëpunimit me qytetarët. Gjithashtu, sfidat e identifikuar dhe prioritetet do të shërbejnë si bazë për grantet të cilat do të ndahen në vitin 2014 në këto Komuna, mbështetur përmes projektit KOSSAC nga Human Security Trust Fund.

UNDP KOSSAC në bashkëpunim me Policinë

e Kosovës, përkatësisht Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, në fund të nëntorit, ka organizuar një fokus grup për vlerësimin e sfidave në Policinë e Kosovës si dhe një trajnim me përfaqësues të bashkësive nga komunat e Fushë Kosovës dhe Obiliqit me qëllim të përfshirjes së tyre në forumet e sigurisë dhe metodave për vlerësimin e rreziqeve në bashkësinë e tyre. Trajnimi është mbajtur nga dy trajnerë të çertifikuar ( anëtarë ) të KLSP-ve ku kanë qenë prezent gjithsejt 35 pjesëmarrës.

## **Objektivi specifik 2 – Metodologjia e punës së policisë së Kosovës bazohet në konceptin e policimit në bashkësi**

Padyshim, se gjatë vitit 2013, Policia e Kosovës ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të promovuar konceptin e policimit në bashkësi. Përmes, hartimit të Strategjisë të Policimit të Bashkësi 2012-2016, Policia e Kosovës ka përcaktuar si vizion të saj se “ është e përkushtuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës përmes promovimit të sigurisë dhe sigurimit të bashkësisë si dhe ngritjen e mirëqenies dhe kualitetin e jetesës”. Po ashtu, Policia e Kosovës si mision ka që përmes policisë në bashkësi dhe zgjidhjes së problemit, mision yni do të jetë angazhimi në partneritetet me bashkësinë, zyrtarët e rekrutuar nga të gjithë sektorët e shoqërisë do të punojnë në fusha të caktuara duke ndërtuar lidhje profesionale përmes kontaktit të vazhdueshëm personal. Ata do të trajnohen që të komunikojnë në mënyrë efikase, të merren me diversitetin (shumëllojshmërinë) dhe të mbajnë lidhje të rregullta me të gjithë

sektorët e bashkësisë. Kontaktet tona me shoqërinë kosovare do të ngrihen përmes aktiviteteve proaktive, me pjesëmarrjen e komunitetit dhe programeve të sigurisë publike të bazuara në bashkësi. Bashkësia do të ndihmojë në identifikimin e problemeve dhe do të marrë pjesë në qasjet kreative të zgjidhjes së problemit për të zhvilluar aktivitetet policore për brengat e tyre.<sup>5</sup> Shumica e kosovarëve (68 përqind) marrëdhëniet polici-komunitet i konsiderojnë të mira apo shumë të mira. Ndërsa, vetëm 9 përqind e të anketuarve i konsiderojnë këto marrëdhënie si të këqija apo shumë të këqija.

### **2.1.2. Zhvillimi i komunikimit të rregullt me të gjitha komunitetet për të qenë të informuar dhe për të bërë të mundur zbatimin e politikave pro-aktive dhe parandaluese**



Misioni i OSBE ka organizuar Nëntë (9) seminare -Komunikimi më KKSBB-të që u mbajtën në 9-të komunat ku KLSP-të ekzistojnë. Njëqindetridhjetë (130) pjesëmarrës përbenin kryesuesit e KKSBB-ve / Kryetarët e komunave, komandantët e stacioneve të policisë, udhëheqësit e sektorëve, udhëheqësit/ zëvendësit e KLSP-ve dhe përfaqësues të MPB, DPBP. Qëllimi i këtyre seminareve ishte për të shqyrtuar mënyrat më efikase të komunikimit në mes të Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB), Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP) dhe Policisë së Kosovës (PK-së).

<sup>5</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2012-2016 “Policimi në Bashkësi”

### 2.2.1. PK harton Strategjinë e Policimit në Bashkësi dhe Planin e Punës

Policia e Kosovës ka hartuar në vitin 2012 Strategjinë e Policimit në Bashkësi 2012-2016, ndërsa në vitin 2013, në bashkëpunim të ngushtë me OSBE-në ka realizuar organizimin e dy punëtorive një-ditore për vlerësimin e zbatimit të kësaj Strategjie.

Qëllimi i këtyre vlerësimeve është që t'u ofrojë pjesëmarrësve një pasqyrë të progresit aktual të zbatimit të Strategjisë së Policimit në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2012-2016.

Qëllimi i kësaj punëtorie është që të sjellë së bashku të gjitha palët e interesuara që punojnë në fushën e policimit në bashkësi dhe të sigurojë një rishikim të detajuar mbi progresin e SPB dhe PV 2012-2016.



Anëtarët e shtyllave të ndryshme të PK-së kan prezantuar një përmbledhje mbi zbatimin e SPB dhe PV 2012-2016 brenda departamenteve të tyre. Shqyrtimi do të përdoret për të identifikuar ndonjë vështirësi të gjatë zbatimit në lidhje me SPB & PV 2012-2016 dhe gjithashtu rekomandimet për implementimet në të ardhmen.

Përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në Kosovë, zyrtarët e PK-së përgjegjës për policimin në bashkësi dhe përfaqësuesit nga EULEX-i, ICITAP-i, organizatave jo-qevritare (Saferworld dhe FIQ) dhe institucione të tjera kanë marrë pjesë në këtë vlerësim.



## 2.2.2 PK i trajnon të gjithë zyrtarët policor për konceptin e policimit në bashkësi.

**Duhet cekur edhe numrin e zyrtarëve të trajnuar nga PK me kapacitete të brendshme (programin për kadetët etj) si dhe numrin e atyre të trajnuar nga ICITAP**

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin



e Trajnimeve Mandatore në kuadër të Policisë së Kosovës, me qëllim të njoftimit dhe kuptimit të drejt të konceptit të policimit në bashkësi, ka inkorporuar disa module në paketën e trajnimit bazik për kadetët e PK-së. Në vitin 2013, në AKSP për generatën #44 dhe #45 të PK-së një zyrtar policor nga DPBP-ja është caktuar dhe ka ligjëruar për policimin në bashkësi dhe atë rreth temave: 1. Çka janë bashkësitë; 2. Forumet e Sigurisë në bashkësi; 3. Parimet e policimit dhe siguria

në bashkësi; 4. Ndërtimi i partneritetit; 5. Zgjidhja e problemit; 6. Shkathtësitë e komunikimit; 7. Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Policimi në bashkësi; 8. Hapat për zbatimin e policimit në bashkësi dhe 9. Strategjia dhe plani i veprimit 2012-2016 "Policimi në bashkësi, PSO dhe Parimit 5.12. Policia e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me OSBE-në në vazhdimësi ka organizuar dhjetë (10) punëtori me mbikëqyrësit operacional në Drejtoritë Rajonale të PK-së, drejtoritë kufitare dhe në drejtorinë e përgjithshme të PK-së lidhur me zbatimin praktik të Strategjisë Policimit në Bashkësi 2012-2016. Pjesëmarrës ishin 183 zyrtarë të PK-së (koordinatorët e sektorit, komandantët e stacioneve, oficerët e planifikimit drejtorët rajonalë dhe stafi i lartë nga DPP).



Qëllimi i këtyre punëtorive ishte që të ngritët niveli i vetëdijesimit tek menaxherët e PK lidhur me zbatimin dhe përfitimet që mund të arrihen nga SPB&PV 2012-2016.

SPB&PV 2012-2016 është dizajnuar të zhvilloj konceptin e policimit në bashkësi në partneritet dhe të transferoj Policinë e Kosovës nga "forca e policisë reaktive" në "shërbim policor pro aktivë, të hapur dhe përgjegjës" duke kombinuar modelet në mes të



Policisë së Udhëhequr nga Inteligjenca (PUI) dhe Policisë së Orientuar nga Bashkësia (POB).

### **2.2.5. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit operativ për siguri në shkolla**

Policia e Kosovës, vazhdimisht monitoron dhe zbaton plane me qëllim të rritjes së sigurisë në shkolla, duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet komunale dhe organizatat e ndryshme në interes të rritjes së sigurisë në shkolla.

Po ashtu, KKSBB-të në mbledhjet e tyre, në vazhdimësi kanë diskutuar për problematiken e sigurisë në shkolla. Një shembull konkret i angazhimit të autoriteteve komunale për monitorimin analitik të sigurisë në shkolla është Komuna e Prizrenit.

Duke qenë se siguria në shkollat e Prizrenit ka qenë një ndër çështjet e cila është diskutuar edhe në mbledhjet e KKSBB-së, ka bërë që të propozojë që institucionet komunale që identifikojnë shqetësimet dhe perceptimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve mbi sfera të ndryshme që ndikojnë në sigurinë e tyre.

Kështu, në nëntor të vitit 2012, zyrtarët e lartë të qeverisë lokale të Komunës së Prizrenit, kanë nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), gjegjësisht Projektin Pulsi Publik për hartimin e Dokumentit të Veprimit për siguri në shkollat e Komunës së Prizrenit i cili dokument është përfunduar në vitin 2013 dhe ofron rekomandime konkrete për rritjen e sigurisë në këtë Komunë, si për KKSBB-në si trup konsultativ ashtu edhe për institucionet tjera përgjegjëse.

### **2.2.9. Policia ushtron kontroll më të rreptë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet**



Divizioni për Siguri në Bashkësi duke marrë për bazë shqetësimet e ngritura në lidhje me numrin e lartë të aksidenteve në komunikacione dhe sigurinë rrugore në përgjithësi, pothuajse të gjitha Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi ka analizuar dhe përgatitur një raport në lidhje me gjendjen e sigurisë në trafikun rrugor si dhe rekomandimet për institucionet përgjegjëse për parandalimin e aksidenteve dhe rritjen në përgjithësi të sigurisë rrugore, poashtu ka organizuar një tryezë të rrumbullakët “Siguria në Trafik” në Komunën e Prishtinës në bashkëpunim të ngushtë me EVSB të Prishtinës.

Sipas këtij raport, ndër faktorët kryesor të shtimit të numrit të aksidenteve në komunikacion konsiderohen:

- Tejkalimi i shpejtësisë së limituar,
- Mos përshtatja e shpejtësisë ndaj kushteve të rrugës,
- Infrastruktura rrugore,
- Gjendja teknike jo e mire e automjeteve,
- Mos mbajtja e distancës mes mjeteve,
- Mungesa e shenjave të komunikacionit dhe mos respektimi i tyre,
- Fluksi i madh i automjeteve nga bashkatdhetarëve nga diaspora të cilët vinë për pushime Verore,
- Vozitja nën ndikimin e alkoolit,
- Shtimi i motoçikletave,
- Bllokimi i trotuareve për këmbësor etj., si dhe një mori faktorësh tjerë që ndikojnë direkt apo indirekt në komunikacion.

Duke analizuar të dhënat statistikore për periudhën kohore Qershor - Gusht 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak 2012 është vërejtur ngritje e aksidenteve në Aksidentet rrugore për 4%, kemi zbritje të aksidenteve me pasoja fatale për 13% dhe ngritje të aksidenteve godit dhe ik për 4%. Ndërsa, sa i përket aksidenteve me lëndime, është vërejtur një ulje për 8%. Është vërejtur se ka pasur ngritje të aksidenteve të komunikacionit rrugor me dëme materiale prej 9 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

### **Synimi Strategjik 3. Kthimi dhe ri-integrimi i qytetarëve nuk paraqitet si fidë teknike për liberalizimin e vizave apo në integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian**

#### **Objektivi Specifik 3.1. Institucionet komunale dhe forumet e sigurisë ndihmojnë në integrimin e qytetarëve të kthyer.**

Divizioni për Siguri në Bashkësi në bashkëpunim me Institucionet lokale si dhe EVSB-të kanë organizuar një (1 ) tryezë e rrumbullakët me temë "Ri-atdhesimi i personave të kthyer" në Ferizaj.

Janë organizuar dy(2) tryeza të rrumbullakëta me temë "Ri-kthimi i komunitetit jo shumicë" të mbajtura në Komunat: Kamenicë dhe Klinë.





## Synimi strategjik 4. Çështjet e ndërlidhura me komunitetet jo-shumicë adresohen në mënyrë institucionale

### Objektivi specifik 4.1. Komunitetet jo-shumicë marrin pjesë aktive në mekanizmat e sigurisë në bashkësi

#### 4.1.2. Mbështetja e projekteve konkrete në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi

Misioni i OSBE në Kosovë është duke e implementuar projektin dy vjeçar në “Mbështetjen e iniciativave të sigurisë në bashkësi përmes Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve)”, me kontributin buxhetor nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë në Prishtinë

Për fazën e parë të vitit 2013 janë përzgjedhë 31 iniciativa të KLSP-ve:



22 iniciativa ndërlidhen me rinovime, rindërtime dhe ndërtime

9 Iniciativa të tjera ndërlidhen me trajnime për ngritje të kapaciteteve, vetëdijesim të publikut, ofrim të përkrahjes teknike përfshirë këtu edhe një kamp për të rinjtë i cili është organizuar nga dy KLSP fqinje.

Në Nëntor, Saferworld, FIQ dhe AKTIV kanë zhvilluar një seminar për shkëmbim të përvojave me 15 organizata lokale të përfshira në projektin e fuqizimit të shoqërisë civile, ku kanë marrë pjesë edhe 11 forume të sigurisë (KKSB, EVSB dhe KLSP), të cilët kanë ndarë përvojat e tyre në adresimin e çështjeve të ndryshme të sigurisë në bashkësi.

## Synimi strategjik 5. Forumet e Sigurisë ndihmojnë intensivisht në implementimin e strategjive nacionale në nivelin lokal

### Objektivi specifik 5.1. Koordinimi ndër-institucional dhe bashkëpunimi ndërmjet mekanizmave të ndryshëm për të lehtësuar zbatimin e strategjive nacionale në nivel lokal

#### 5.1.1. Kryetarët e Komunave janë të njoftuar me strategjitë nacionale dhe i adresojnë ato në takimet e rregullta të KKSBB sa herë që paraqitet nevoja



Në Qershor të vitit 2013, misioni i OSBE-së ka mbështetur konferencën për të gjithë kryesuesit e KKSBB-ve: Qellimi i kësaj konferencë ishte prezantimi i Udhëzuesit për Hartimin e Planit Vjetor të Punës për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi dhe prezantimi i të gjeturave gjatë vizitave të KKSBB-ve lidhur me zbatimin e UA 27/2012 MPB-03/2012 MAPL të KKSBB-ve. Përveq anëtarëve të grupit drejtues edhe 50 pjesëmarrës (kryetar komunash, nënkryetar, përfaqësues të MPB Grupit drejtues për monitorimin e zbatimit të SNSB dhe PV 2011-2016, OSBE, ICITAP UNDP, media) morën pjesë në këtë konferencë.

#### 5.1.4. Formësohet bashkëpunimi mes koordinatoreve nacional të emëruar nga qeveria apo ministritë përkatëse dhe forumeve të sigurisë



Misioni i OSBE në Kosovë ka mbështetur MPB në ndërtimin e kapaciteteve për krijimin e Zyrës Koordinuese për Siguri e Bashkësi dhe bërjen funksionale me staf të trajnuar. Në fund të muajit maj, Zyra Koordinuese është pajisur me inventar dhe stafi është i pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për modulet ndërtimit të kapaciteteve për forumet e sigurisë në bashkësi.

## Objektivi specifik 6. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe koordinimi i aktorëve në nivel lokal dhe qendror për përmirësimin e sigurisë publike

### 6.1 Promovimi i forumeve të sigurisë në ueb-faqe

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë në bashkëpunim me Zyrën për Informim dhe Marrdhënie me Publikun në kuadër të PK-së, ka bërë azhurnimin e ueb-faqes së policisë respektivisht vegëzen e Policimit në bashkësi ku përveç KLSP-së janë shtuar edhe nën-vegëza për forumet e tjera të sigurisë, Zyrën Koordinuese për Siguri në Bashkësi si dhe rreth projekteve, aktiviteteve dhe fushatave të ndryshme vetëdijesuese.

<http://www.kosovopolic.com/?page=1,3>



### 6.2. Sensibilizimi i qytetarëve për forcimin e bindjes për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër-fetar

#### 6.2.1. Organizmi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërfetar

Misioni i OSBE ka organizuar 15 (pesëmbëdhjetë) forume të dialogut ndër fetar ndër fetare me liderët fetarë në pesë rajonet e Kosovës, 32 forume ndër-fetare të dialogut duke angazhuar të rinjtë (Prishtinë, dhe Mitrovicë dhe një Konferencë Dialogu ndër-fetarë).

## **6.2.2. Përkrahja e grupeve vullnetare për promovimin e aktiviteteve të ndryshme**

Misioni i OSBE në Kosovë ka organizuar një trajnim dy-ditorë për organizatat e shoqërisë civile nga e gjithë Kosova për të identifikuar dhe për t'iu përgjigjur shkeljeve të lirisë së shprehjes dhe të gjuhës së urrejtjes. 30 pjesëmarrës morën pjesë në këtë trajnim.

### **Synimi Strategjik 7. Parandalimi dhe zvogëlimi i krimit në bashkësi**

#### **Objektivi specifik 7.1 Fuqizimi kapaciteteve njerëzore të institucioneve dhe forumeve tjera të sigurisë që merren me parandalimin e krimit**

##### **7.1.1. Trajnimet në vazhdimësi për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të akterëve**

#### **Misioni OSBE ka organizuar një numër aktiviteteve ;**

- Trajnimi i 49 oficerëve të PK-së të cilët janë anëtarë të KLSP-mbi krimet e urrejtjes.
- Një punëtor dy-ditorë për të rritur ndërgjegjësimin në mesin e të rinjve mbi "krimet e urrejtjes" dhe "incidentet e me motive të urrejtjes".
- Tryezat Rajonale për trajnimin e KKS-ve mbi "krimet e urrejtjes" dhe "incidente të motivuara nga urrejtja".
- Trajnimi i trajnerëve për 23 zyrtarë të PK-së me qëllim të aftësuar ata për të ligjëruar nxënësve të shkollave të larta në krimet e urrejtjes.
- Një punëtor -një-ditorë (pilot) me OJQ-në lidhur me përgjigjen dhe parandalimin e krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja. 15 përfaqësues të OJQ-ve nga bashkësitë të ndryshme të Kosovës morën pjesë dhe diskutuan rreth mjeteve për t'iu përgjigjur dhe për të parandaluar krimet e urrejtjes dhe incidentet të motivuara nga urrejtja.
- Organizimi i një seminari një-ditorë për incidentet e motivuara nga urrejtja dhe paragjykimin me të rinjtë nga bashkësitë e ndryshme. 15 të rinjtë / studentë nga bashkësitë e ndryshme (serbë, romë, shqiptarë) nga Graçanica morën pjesë në një seminar për diskutimin e urrejtjes, dhe paragjykimet në mes të komuniteteve të ndryshme të Kosovës.
- Shtypja e broshurës, Legjislacioni i ndërlidhur me Sigurinë në Bashkësi: rregulloret e ndryshme të hartuara për sigurinë në bashkësi. 1935 kopje të një broshure / Legjislacioni i ndërlidhur me Sigurinë në Bashkësi janë shtypur dhe shpërndarë tek anëtarët përkatës të të gjitha forumeve për siguri në bashkësi në Kosovë.



Me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve, Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë në bashkëpunim me Njësinë për Hetimin e Krimeve Mjedisore dhe me përkrahje të Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka hartuar dhe shtypur broshurën kundër krimeve mjedisore dhe atë në 5000 kopje (4000 shqip, 700 serbisht dhe 300 anglisht) të cilat janë shpërndarë nëpër të gjitha rajonet e policisë.

### Broshura kundër krimeve mjedisore:



#### **7.1.4. Intervenimi i hershëm dhe parandalimi i krimit në nivel lokal/specifik**

Divizioni për Siguri në Bashkësi ka organizuar dy ( 2) tryeza të rrumbullakëta “Dhuna në Familje-Thyeje Heshtjen !” në Komunën e Dragashit dhe të Junikut.

Misioni i OSBE ka organizuar sesione informuese të organizuara në komunën e Ferizajt mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Tre sesione informuese (dy në shkollat e mesme dhe një në një shkollë fillore) kanë marrë pjesë 162 studentë, duke përfshirë 9 përfaqësuesit e komunitetit egjiptian të Kosovës romëve, dhe ashkalive Kosovës.

Shtypja dhe shpërndarja e materialeve informuese. 1000 fletëpalosje (600 kopje në gjuhën shqipe, 300 në gjuhën serbe dhe 100 në gjuhën rome) dhe 300 postera (200 kopje në gjuhën shqipe, 50 në gjuhën serbe dhe 50 në gjuhën rome).

#### **Objektivi specifik 7.2 Ngritja e vetëdijesimit të bashkësisë për rrezikun nga përdorimi i narkotikëve.**

Divizioni për Siguri në Bashkësi si dhe EVSB-të kanë organizuar një (1) tryezë të rrumbullakët me temë “ Drogat në nivel Lokal” në Komunën e Pejës.

### 7.3 Ngritja e vetëdijesimit të bashkësisë mbi çështjet e trafikimit me qenie njerëzore

Divizioni për Siguri në Bashkësi në bashkëpunim të ngushtë me Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi si dhe ICITAP kanë organizuar Tryeza të rrumbullakëta për ngritjen e vetëdijës te qytetarët në nivel lokal rreth dukurisë së trafikimit me qenje njerëzore.

Janë organizuar gjashtë (6) tryeza të rrumbullakëta me temë “Adresimi i trafikimit me qenje njerëzore në nivel lokal” në këto Komuna: Podujevë, Shtime, Partesh, Ranillug, Shtërpçë dhe Pejë.



#### 7.3.1 Organizimi i fushatave mediale në nivel lokal ndihmuar nga forumet e sigurisë (KLSP, EVSB, KKSB)

OSBE ka organizuar Fushata në mbështetje të Koordinatorit Anti-Trafikim "Hapni sytë tuaj. Jeni të vetëdijshëm" janë shtypur e 1500 fletëpalosje, 300 postera në gjuhën shqipe, serbe dhe rome dhe si shtypja dhe shfaqja e pesë billbordeve në nivel lokal. Deri në fund të dhjetorit 2013 të gjitha fletëpalosjet dhe posterat janë shpërndarë në zonat rurale të Kosovës. Në qershor të vitit 2013, pesë billborde u shfaqen për tri javë në komuna: dy tabela në gjuhën serbe në Graçanicë, Partesh, dy në gjuhën rome në Gllogovc dhe Fushë Kosovë dhe një në gjuhën shqipe në Ferizaj . Deri në fund të dhjetorit 2013 të gjitha fletëpalosjet dhe posterat janë shpërndarë në zonat rurale të Kosovës. Në qershor të vitit 2013, pesë billborde u shfaqen për tri javë në komuna: dy tabela në gjuhën serbe në Graçanicë, Partesh, dy në gjuhën rome në Gllogovc dhe Fushë Kosovë dhe një në gjuhën shqipe në Ferizaj



**hapni  
sytë**

**KE KUJDES!**



### **7.3.2 Të zhvillohen dhe avancohen kapacitetet e institucioneve në nivel lokal/qendror dhe OJQ-ve, në parandalim të trafikimit me qenie njerëzore**

Një ditë trajnimi- Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ky trajnim është kryer me OJQ-të Serbe për të Drejtat e Njeriut. Shtatë përfaqësues të OJQ-ve të të Drejtave të Njeriut serbë të Kosovës janë trajnuar mbi çështjet e kundër trafikim. Gjysme ditë trajnimi mbi raportimin për ndihmë për katër operatorët e linjës Zyrtarët e shëndetësisë kanë qenë të trajnuar për herë të parë mbi çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me PSV te reja mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunës në familje. Ata kanë nevojë për trajnime të mëtejshme në mënyrë që të përputhen me PSV-ve për viktimat e trafikimit dhe PSO-të për viktimat e dhunës në familje te miratuar. Gjashtë sesione një-ditore trajnimi (një në qendër dhe pesë në rajonet), për zyrtarët e shëndetësisë nga Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe të urgjencës, për trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunës në familje. Trajnimi u organizua nga OSBE në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Temat e diskutuara ishin në rolin e zyrtarëve të shëndetësisë në identifikimin, referimi dhe asistimi i të mbijetuarve të trafikimit të qenieve njerëzore (në përputhje me PSV reja për Trafikimin me Qenie Njerëzore) dhe dhunës në familje. Më tej, specifikat e trajtimit mjekësor të të mbijetuarve u prezantuan nga një mjek specialist, kontraktuar nga OSBE-ja. Trajnim për procedurat e miratuara i Standarde të Operimit (PSO) për Viktimat e Trafikimit. Dy trajnime tre-ditore janë organizuar në rajonin e Gjilanit dhe morën pjesë 48 përfaqësues të aktorëve kryesorë kundër trafikim dhe ofruesit e shërbimeve, duke përfshirë tre serbë të Kosovës.

## Synimi strategjik 8 – Tranzicion i suksesshëm i EVSB

Gjatë vitit 2013, ICITAP është angazhuar që të zbatojë Planin për Tranzicion të EVSB-ve nga ICITAP tek MPB, përkatësisht Divizioni për Siguri në Bashkësi. Aktivitetet e ndërmarra në këtë drejtim kanë qenë pajisja me kartela nga MPB-DSB për të gjithë anëtarët e EVSB-ve në Kosovë, hapja e një zyre koordinuese për forumet e sigurisë në Akademinë si dhe organizimi nga vetë EVSB-te, në mbështetje të MPB-së të KE të EVSB-ve. Mund të thuhet, së janë bërë hapa të mirë në bartjen e kompetencave nga ICITAP tek MPB dhe është përmbushur faza e parë e tranzicionit, ndërsa mbetet që gjatë viti 2014, ky proces të përmbyllet me sukses.



## SFIDAT

Duke marrë për bazë Planin e Veprimit të Strategjisë 2011-2016, ku janë paraparë një numër synimesh strategjike dhe objektivash, GD-ja ka vlerësuar se janë një numër synimesh dhe objektivash të cilat adreson dhe janë të parapara me dokumente tjera nacionale të hartuara pas Strategjisë për Siguri në Bashkësi.

Synimi strategjik që ka të bëjë me Kthimin dhe ri-integrimi i qytetarëve dhe që si objektiv specifik parasheh që Institucionet komunale dhe forumet e sigurisë ndihmojnë në integrimin e qytetarëve të kthyer, është një prej synimeve që tani më adresohet nga një strategji e veçantë e hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme siç është Strategjia Kombëtare për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Plani i Veprimit.

Megjithatë, në përgjithësi është vlerësuar se është bërë një punë e mire në aspektin e ri-integrimit dhe se kjo fushë tani është mirë e mbuluar me Strategji dhe legjislacion përkatës si dhe brenda MPB-së është Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion i cili harton politikat, strategjitë, planet e veprimit dhe siguron koordinim të ngushtë me institucionet dhe organizatat tjera përkatëse për personat e riatdhesuar.

Po ashtu, edhe MASHT- ka kontribuar në aspektin e ri-integrimit të fëmijëve të riatdhesuar dhe vetëm gjatë vitit 2013 ka pranuar në sistemin shkollor 640 nxënës të ri-atdhesuar.

Një tjetër synimi strategjik parasheh që institucionet e sigurisë janë të afta për t'iu përgjigjur kërcënimeve që mund të vijnë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe ekzistojnë plane për reagim dhe rimëkëmbje pas fatkeqësisë.

Edhe për këtë synim GD-ja ka propozuar që të ofrojë mbështetje kur është e nevojshme por se këto janë përgjegjësi e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe se aktivitetet e parapara në Strategjinë për Siguri në Bashkësi duhet të jene vetëm mbështetëse.

Edhe synimi strategjik që parasheh Parandalimin dhe zvogëlimin e krimit në bashkësi është një tjetër temë e cila tani më mbulohet me një numër aktivitetesh konkrete përmes Strategjisë Nacionale e Republikës së Kosovës për Parandalim të Krimit dhe Plani i Veprimit 2013-2017.

Grupi Drejtues, ndër të tjera ka ofruar një numër rekomandimesh mbi bazën e të cilave është hartuar edhe Plani i Punës për Grupin Drejtues për vitin 2014.

# REKOMANDIMET

Rekomandimet e Grupit drejtues për implementimin dhe arritjen e objektivave të parapare me Planin e Veprimit të Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi janë:

- Përmirësimi dhe komunikimi më i rregullt në mes të MPB-së dhe MAPL-së;
- Të shfrytëzohen më shumë rrjetet sociale web-faqet nga MPB-ja, Komunat, Policia e Kosovës si dhe burimet e mediave rreth promovimit të Forumeve të Sigurisë;
- Hartimi i draftit nga grupi drejtues për stimulimin e grupeve për punë vullnetare nëpër Komuna;
- Organizimi i një tryeze të rrumbullakët për parandalimin e huliganizmit në Sport;
- Funksionalizimi i Zyrës Koordinuese për Forumet e Sigurisë me qëllim që të jetë pikë kontakti për Forumet e Sigurisë;
- Të organizohet një takim për rishikimin e Ligjit të tubimeve publike, pasi nuk është në harmoni me direktivat e BE-së;
- Shtrirja dhe rishikimi i funksionimit të KLSP-ve ekzistuese (nuk ka në çdo Komunë të themeluar KLSP, kurse në ndonjë stacion të PK –së kemi 3-4 KLSP të themeluar);
- Të shqyrtohet dhe themelohen edhe dy KLSP-të të cilat janë kërkuar nga dy Komunat nga komandanti i PK-së në Gjakovë dhe Skenderaj;
- Të futet dhe diskutohet baza ligjore në Udhëzim Administrativ për themelimin e EVSB-ve
- Pas zgjedhjeve të vërejmë kontakte me zyrtarët në veri të Mitrovicës rreth zhvillimit të forumeve të sigurisë edhe në atë pjesë të Kosovës;
- Organizimi i kampanjave publike për njohjen e Forumeve edhe në veri pas zgjedhjeve;
- Të zbusim ndarjet etnike, duke mos i adresuar vetëm komunitetin jo-shumicë por t'i nxisim për bashkëpunim me komunitetin shumicë;
- Të punojmë në ndërlidhjen e aktiviteteve të kësaj strategjie me strategjinë e komunitetit RAE (romë, ashkali, egjiptian) si dhe me Departamentin për Ri-integrimeve dhe rikthim dhe strategjitë e tjera;
- MAPL-ja t'i vlerësoj vendimet për themelimin e KKSBB-ve për pjesëmarrjen e gjinisë femërore;
- Të formohet një dokument Strategjik për ekzistimin e Forumeve të Sigurisë;
- Për funksionalizimin e GD duhet të themelohet me vendim Sekretaria e Grupit Drejtues e përbërë nga zyrtarët e MPB-së, Divizionit për Siguri në Bashkësi si dhe Policia e Kosovës.



### **RAPORTI U PËRPILUA NGA:**

Grupi drejtues për monitorimin e Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Plani i Veprimit 2011-2016, në përbërje të:

- |                                                          |                                                                  |
|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|
| 1. <b>Imer THAÇI</b> , DSB/MPB, KRYESUES                 | 10. <b>Lulzim FUSHTICA</b> , US DOJ - ICITAP                     |
| 2. <b>Major Çlirim HAJDINI</b> , PK, ZV. KRYESUES I PARË | 11. <b>Jeta TELA</b> , UNDP/KOSSAC                               |
| 3. <b>Xhevat TAFA</b> , MAPL, ZV. KRYESUES I DYTË        | 12. <b>Nazim HALITI</b> , FORUMI PËR INICIATIVA QYTETARE – FIQ - |
| 4. <b>Sanela SADIKOVIC</b> , ZKM, ANËTARE                | 13. <b>Ferdinand NIKOLLA</b> , SAFERWORLD                        |
| 5. <b>Hajrush KURTAJ</b> , MFSK, ANËTARË                 |                                                                  |
| 6. <b>Avni REXHA</b> , MASHT, ANËTARË                    |                                                                  |
| 7. <b>Shqipe ARIFAJ</b> , AKK, ANËTARE                   |                                                                  |
| 8. <b>Fitim TAHIRI</b> , MPB, ANËTARË                    |                                                                  |
| 9. <b>Rifat MARMULLAKU</b> , MISIONI I OSBE-SË NË KOSOVË |                                                                  |

### **SEKRETARIA E GRUPIT DREJTUES:**

1. **Ganimete GËRBOVCI**, MPB
2. **Mentor CAKOLLI**, PK
3. **Labinot SADIKU**, MPB



**Dizajni: Mentor CAKOLLI**





PRISHTINË  
Mars, 2014